

Këshilli i Lartë i Prokurorisë merr pjesë në trajnimin “Praktika e Gjykatës Evropiane Për të Drejtat e Njeriut” mbi çështjet disiplinore të magistratëve” i organizuar nga EURALIUS



Programi i BE për asistencën në zbatimin dhe konsolidimin e reformës në drejtësi në Shqipëri, EURALIUS në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, organizoi sot trajnimin me temën “Praktika e Gjykatës Evropiane Për të Drejtat e Njeriut” mbi çështjet disiplinore të magistratëve”. Në takim ishin të pranishëm anëtarët e Këshillit, këshilltarët ligjorë të Komisionit të Disiplinës dhe ekspertë ligjorë të misionit EURALIUS.

Objektivat e trajnimit synojnë prezantimin e legjislacionit shqiptar në fuqi për çështjet disiplinore të magistratëve dhe harmonizimin e tij me praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në çështjet disiplinore të magistratëve dhe zbatimin i garancive të paraqitura nga GJEDNJ në kontekstin shqiptar.

Ekspertët e EURALIUS paraqitën para të pranishmëve raste konkrete nga vende anëtare të BE dhe debati mbi to.

Në tetor të vitit 2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë i kërkoi EURALIUS-it të ofronte një vështrim të përgjithshëm të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në lidhje me procedimet disiplinore ndaj magistratëve të zhvilluara nga autoritetet përkatëse të brendshme. Kjo praktikë do t'i shërbejë Këshillit si një udhëzim për t'u konsideruar në procedimet disiplinore në vijim që do të zhvillohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe vetë Këshilli.

Në fjalën e tij, kreu i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Gent Ibrahimi theksoi ndryshimet rrënjësore që ka pësuar sistemi legjislativ përsa i përket procesit disiplinor ndaj magistratëve me miratimin dhe hyrjen në fuqi të paketës ligjore të reformës në drejtësi në Nëntor 2016 dhe mënyrën si zbatohen këto ndryshime nga institucionet e reja të drejtësisë.

Sipas Ibrahimit, procesi disiplinor duhet të ofrojë siguri maksimale magistratëve në trajtimin e ankesave kundër tyre, duke garantuar përgjeshmërinë, pa anësinë, pavarësinë dhe transparencën e institucioneve vendimarrëse për procesin disiplinor.

Në këtë këndvështrim, Ibrahimi nënvizoi se praktika ka treguar se është e nevojshme aplikimi i një qasje të unifikuar në KLP, KLGJ dhe ILD në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të reja ligjore për procedimin disiplinor në përputhje me praktikat orientuese të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e të Drejtës së Njeriut.